

URDHËR
Nr. 166, datë 26.7.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe ligjit nr. 118/2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për dhënien e licencës për subjektet të cilat ushtrojnë veprimtarinë si trup inspektimi i mjeteve që kryejnë transport të disa mallrave të rrezikshme, në përputhje me parashikimet në ligjin nr. 118/2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati.

2. Në ushtrimin e kompetencës së deleguar, z. Hantin Bonati, ndjek dhe zbaton procedurat dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 118/2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”.

3. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhri deri në miratimin e një urdhri të dytë.

4. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku